LIGJ
Nr.9800, datë 10.9.2007

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR.9643, DATË 20.11.2006 "PËR PROKURIMIN PUBLIK"

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Në nenin 3 bëhen ndryshimet dhe shtesat si më poshtë:
a) në pikën 2, pas fjalëve "janë kontratat për shërbime" shtohet fjala "publike";
b) pika 2 bëhet pika 3;
c) pika 3 bëhet pika 2;
ç) në pikën 20 rreshti i parë hiqen fjalët "me negocim dhe pa njoftim publik".

Neni 2

Në nenin 9 rreshti i dytë parafjala "për" zëvendësohet me parafjalën "me".

Neni 3

Në nenin 12 pika 5 fjalia e dytë, pas fjalës "mbështetje" shtohen fjalët "në formën e këshillave dhe të udhëzimeve".

Neni 4

Në nenin 13 pika 2, pas shkronjës "k" shtohet shkronja "l" me këtë përmbajtje:
"l) kryen çdo detyrë tjetër që i ngarkohet me ligj."

Neni 5

Në nenin 19 pika 2 rreshti i parë fjala "pagat" hiqet.

Neni 6

Në nenin 21 pika 2 shkronja "c" fjala "të pasuksesshëm" zëvendësohet me fjalën "të suksesshëm".

Neni 7

Në nenin 29 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:
a) në fund të pikës 4 shtohen fjalët "sipas kushteve të përcaktuara në këtë ligj";

b) në pikën 5 fjala “blerjet” zëvendësohet me fjalën “prokurimet”.

Neni 8

Në nenin 33 bëhen këto ndryshime:

a) në pikën 1 rreshti i parë, pas fjalëve “me vlerë mbi” shtohen fjalët “ose nën”;

b) në pikën 2 shkronja “c” riformulohet si më poshtë:

“c) kur për arsye të nevojës ekstreme, të shkaktuar nga ngjarje të paparashikueshme nga autoriteti kontraktor, afati kohor i parashikuar në nenin 43 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 për njoftimin e kontratës për procedurat e hapura, të kufizuara ose me negocim, me publikim, nuk mund të respektohet. Rrethanat e përmendura për të justifikuar nevojën ekstreme nuk duhet të shkaktohen në asnjë rast nga veprimi ose mosveprimi i autoritetit kontraktor. Kushtet dhe rrethanat e përdorimit të kësaj procedure përcaktohen në rregullat e prokurimit.”.

Neni 9

Në nenin 34 pika 1 fjalia e tretë fjalët “kërkohen të paktën 5 oferta” zëvendësohen me fjalët “kërkohet të ftohen të paktën 5 operatorë ekonomikë”.

Neni 10

Në nenin 38 pika 1 riformulohet si më poshtë:

“1. Autoriteti kontraktor, që kryen procedura prokurimi për kontrata publike me anë të procedurës së hapur, të kufizuar, me negocim, me shpallje paraprake të njoftimit ose kërkesës për propozim, në përputhje me nenet 30, 31, 32 e 34 të këtij ligji, ose kur fillon procedurën konkurs projektimi, sipas nenit 35 të ligjit, bën njoftimin publik për kryerjen e llojit përkatës të prokurimit publik.”.

Neni 11

Në nenin 42 pika 1 fjalia e parafundit riformulohet si më poshtë:

“Në çdo rast, kur ndryshohen dokumentet e tenderit, autoriteti kontraktor e zgjat afatin kohor për dorëzimin e ofertës me 5 ditë, ndërsa për prokurimet mbi kufijtë e lartë monetarë me 10 ditë.”.

Neni 12

Në nenin 43 bëhen këto shtesa e ndryshime:

a) në pikën 3, pas fjalëve “me shpallje të njoftimit” shtohen fjalët “me vlerë më të lartë se kufiri i lartë monetar”;

b) në pikën 6 shkronja “b” fjalët “është botuar njoftimi i kontratës”, zëvendësohen me fjalët “është dërguar te kandidatët ftesa për ofertë.”.

Neni 13

Në nenin 45 pika 1, pas shkronjës “ç” shtohet shkronja “d” me këtë përmbajtje:

“d) falsifikim.”.

Neni 14

Në nenin 48 pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Autoriteti kontraktor, kur jep sqarime ose bën ndyshime në dokumentet e tenderit, vepron në përputhje me nenin 42 të këtij ligji.”.

Neni 15

Në nenin 52 pika 5 hiqen fjalët “dhe i vlerësimit të”.

Neni 16

Në nenin 64 pika 2 rreshti i dytë, pas fjalëve “dhe para lidhjes së kontratës” shtohen fjalët “kur nuk vendos pezullimin”.

Neni 17

Pas nenit 75 shtohet neni 75/1 si më poshtë:

“Neni 75/1
Dispozitë e veçantë

1. Procedurat e nisura në përputhje me ligjin nr.7971, datë 26.7.1995 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, përfshirë edhe ankimin, trajtohen sipas ligjit nr.7971.

2. Shkronja “ç” e pikës 3 të nenit 13 zbatohet edhe në rastin e kontratave të nënshkruara para hyrjes në fuqi të këtij ligji.

3. Pikat 2 shkronja “a” dhe 5 të nenit 33 zbatohen edhe për kontratat e lidhura pas përfundimit të procedurave të prokurimit, në bazë të ligjit nr.7971, datë 26.7.1995 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, edhe kur kjo nuk është parashikuar në kontratën fillestare.”.

Neni 18
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5460, datë 14.9.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi